

KUBURIZMI - ADHURIMI I VARREVE

Dr.Sulltan El Umejri

KUBURIZMI - ADHURIMI I VARREVE

Dr. Sulltan El Umejri

Përshtati:

Zejd Haziri

Redaktor gjuhësor:

Arian Koçi

Ballina & faqesja:

Avni G. Gashi

Botimi parë:

1444/2022

Boton:

”Botimet Udhaebesimtarëve” – Tiranë

Shtypi:

“Mileniumi i Ri” - Tiranë

Formati:

12x16.5cm

Tirazhi:

250 copë

© Të gjitha të drejtat e botimit dhe publikimit të tërsishëm apo të pjesërishtëm, janë të rezervuara dhe të mbrojtura me ligj!

KUBURIZMI

ADHURIMI I VARREVE

DR. SULLTAN EL UMEJRI



بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit,
Mëshirëplotit!

KUPTIMI I KUBURIZMIT DHE HISTORIA E TIJ

Kuburizmi, adhurimi i varreve, është infinitiv që buron nga njëjësi i fjalës kuburij, kurse shumësi tij është kuburitë. Kjo fjalë tregon atë që e tepron me varret duke i konsideruar të shenjta dhe i shndërron në objekt të veprave dhe adhurimeve të ndaluara (haram) në sheriatin islam, sikur ai që i merr për objekt tavafi, namazi, dhikri, therjeje, zotimi ose sikur ai që i merr si objekt të kërkimit të ndihmës (istigathe) përpos Allahut të Lartësuar e kështu me radhë.

Një grup dijetarësh këtë term e kanë përdorur me këtë kuptim, siç thotë El Emir Es Sanani, rahimehullah: “Zotim me pasuri për të vdekurin e gjëra të

ngjashme, therje (e një kafshe) te varri dhe ndërmjetësim me të dhe kërkim i nevojave prej varrit, siç kanë vepruar njerëzit para Islamit (në xhahilijet). Këta ata e vepronin duke e quajtur idhull e put, kurse adhuruesit e varreve i quajnë evlia, varr ose tyrbe, por emrat nuk kanë ndikim e as nuk i ndryshojnë kuptimet, që janë domosdoshmëri gjuhësore, logjike dhe sheriatike¹”.

Ibën Tejmije përdori termin “el mekabirijin” për të dëftuar ekstremistët e varreve dhe tha: “Pa dyshim se të tillët kur luten me përkushtim e insistim të madh, siç veprojnë adhuruesit e varreve në lutjet e tyre, gati se nuk u kthehet asnjë lutje, veçse nëse ka ndonjë pengesë²”.

Kuburizmi me këtë kuptim është një devijim i përhapur në historinë e njerëzimit dhe prania e tij ishte e fuqishme te popujt paganë dhe paraislamikë. Siç thonë disa dijetarë, shfaqja e saj e parë ishte te populli i Nuhut, alejhi selam, edhe pse më e saktë

¹ “Tat’hir el Iatikad”, fq. 61. Për përmbajtje të tjera të kuburizmit shih librin “Kuburizmi dhe qëndrimet e dijetarëve rreth tij” të Ahmed el Mualim.

² “Iktidaus Siratil mustekim”, 2/209 dhe 2/267.

është se tekstet nuk përmendin që populli i Nuhut e teptoi me varret e të vdekurve, por e teptoi me imazhet dhe skulpturat e tyre, pasi nuk përmendet në rrëfime se ata qëndronin te varret e tyre dhe e tepruan deri në adhurim.

Megjithatë teprimi me varret dhe shndërrimi i tyre në objekt të ortakërisë me Allahun (idhujtari) dhe shpikja e risive që kundërshtojnë fenë e Allahut është e përhapur te popujt paganë dhe para ardhjes së Islamit. Është konfirmuar me fakte se hebrenjtë dhe të krishterët i shndërruan varret e Pejgamberëve të tyre në faltore, siç transmetohet nga Pejgamberi, alejhi selam: “Allahu i ka mallkuar hebrenjtë dhe të krishterët sepse i morën varret e Pejgamberëve të tyre për faltore³”. Nga Ebu Hurejra, radijAllahu anhu, transmetohet se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “Allahu i vraftë hebrenjtë dhe të krishterët, i morën varret e Pejgamberëve të tyre për faltore!”⁴

³ Transmetojnë Buhariu (48) dhe Muslimi (1121).

⁴ Transmetojnë Buhariu (437) dhe Muslimi (1122).

Këto hadithe i vërteton realiteti i shumë faltoreve hebraike dhe të krishtera, të cilat janë ndërtuar mbi varret e Pejgamberëve dhe Profetëve të tyre⁵.

Kuburizmi dominonte edhe në vendbanimet e moçme të Egjiptit. Autori i librit “El Meherxhanat ed Dinije”, Blejkër, përmend se egjiptianët e moçëm nuk e vërenin dallim mes Zotit dhe njeriut dhe kishin bindje se njeriu kur vdes, arrin një fuqi të madhe. Ai shkruante se nuk shihte dallim të madh mes bindjes së popullit aktual rreth *evliave* dhe aftësisë së tyre për të pasur lëvizje në kozmos dhe bindjes së egjiptianëve të vjetër për të vdekurit e tyre⁶.

Siç kanë konstatuar një numër studiuesish, shenjat e madhërimit dhe të teprimit në varret e të devotshmëve në Egjipt në kohët e vona ngjajnë në masë të madhe me shenjat e teprimit dhe shenjtërimit të varreve tek egjiptianët e lashtë dhe thanë se

⁵ Shembuj të tillë mund të gjesh në librin “Dum’atun ala et Tevhid” (118-119) dhe “El atharu vel meshahid” (26-52) të Abdulaziz Xhefir.

⁶ “Mevalidu el Misër el Mahruse”, Arafat Abduh Alij (23), nga “Dum’atun alet tevhid”, fq. 114.

historia pagane e Egjiptit po kthehet sërish në praktikë⁷.

Raziu përmend se disa grekë në të kaluarën i merrnin varret si objekt për kërkim të begatisë dhe arritje të mirësive. Ai thotë: “Kam dëgjuar se shokët e Aristotelit sa herë që kishin probleme për hulumtimin e ndonjë çështjeje, shkonin te varri i tij dhe hulumtonin për atë çështje aty, pastaj e gjenin zgjidhjen dhe nuk kishin probleme më⁸”.

Edhe filozofët kishin parime që detyronin teprimin të varret (adhurimin), meqë kishin bindje se shpirtat liroheshin të të vdekurit me çështje të dobishme për ta dhe për sqarimin e parimeve të tyre. Ibën Tejmije thotë: “Disa njerëz që hynë në fenë e sabiinëve dhe të idhujtarëve menduan se shefati (ndërmjetësimi) i Pejgamberit për umetin e tij nuk ka nevojë për lutje nga ai, por mëshira e cila zbret të Pejgamberi, zbret edhe tek ai që kërkon ndërmjetësim për të, pa e vërejtur Pejgamberi këtë, as pa lutje nga ai. Këtë e ilustruan me reflektimin e rrezeve të diellit kur bien mbi një trup që vezullon,

⁷ “Dum’atun alet Tevhid” fq. 114-117.

⁸ “El Metalib el Alije” (7/228).

që pastaj reflekton te të tjerët, si dielli kur bie mbi ujë ose pasqyrë dhe rrezet e tij reflektojnë edhe në mur apo diçka tjetër dhe drita arrin në vendin tjetër përmes rrezeve. Kështu edhe mëshira lirohet te shpirtrat e mirë, si shpirtrat e Pejgamberëve dhe të devotshmëve, pastaj përmes tyre lirohet te shpirtrat e lidhur me ta. Sikurse rrezet kanë nevojë për paralele, po ashtu edhe zbritja e mëshirës ka nevojë që njeriu të drejtohet kah shpirtrat e devotshëm dhe ata dobinë nga vizita e varreve e nxorën nga ky kontest. Ata gjithashtu thanë: “Shpirtrat e ndarë bashkohen me shpirtrat vizitorë dhe kështu fuqizohet ndikimi i tyre”⁹.

Kuburizmi ishte i shtrirë edhe në Indi dhe rreth saj¹⁰, po ashtu edhe tek arabët para Islamit, derisa erdhi Islami dhe i shpalli luftë kuburizmit. Në fillim të Islamit ishte e ndaluar vizita e varreve. Pejgamberi, alejhis salatu ves selam, kishte urdhëruar për rrëzimin e çdo varri të ngritur dhe kishte ndaluar

⁹ “El Istigathe fir Reddi alet Bekri” (1/270) si dhe “El Madnun” të Gazaliut (118-120) dhe “El Metalib” i Razit (7/276).

¹⁰ Shih “Dum’atun alet tevhid”, fq. 119.

nga shndërrimi i varreve në festa dhe nga ndriçimi i tyre me qirinj e punë të tjera, të cilat parandalojnë nga teprimi në varre dhe ekzistimi i kuburizmit ose vazhdimi i tij.

ZHVILLIMI I KUBURIZMIT NË HISTORINË ISLAME

Në historinë islame gjendja e kuburizmit dhe e ndërtimit mbi varre si dhe lidhja mes tyre ishte e pavërejtur për një kohë të gjatë, saqë në fillim të historisë islame nuk njihej ndonjë shenjë e kuburizmit, ndaj nuk kishte as ndonjë tyrbe, as ndonjë faltore të ndërtuar mbi varr, madje nuk kishte as kupola e as objekte mbi varre.

Në realitet këto gjëra nuk ndodhën në umetin islam veçse në kohët e vonshme, në fund të shekullit të tretë ose pas tij, për shkak të devijimit të ndjekësve të medhhebit shiit, të cilët janë të parët që shpikën teprimin në varre dhe metodat e devijuara të adhurimit. Shiitët konsiderohen si themeluesit e kuburizmit në umetin islam.

Kur filloi shfaqja e disa shenjave të teprimit në varre në fillim të historisë islame, udhëheqësit dhe dijetarët i refuzonin ato dhe i largonin. Këtë e vërteton imam Shafiu kur thotë: “Kam parë në Mekë disa udhëheqës duke i shkatërruar ato që ndërtoheshin mbi varre dhe askush nga fukahatë nuk e qortonte

këtë veprim¹¹”. Kjo aludon se bidati i kuburizmit filloi të merrte formë qysh në kohën e imam Shafiut, mirëpo udhëheqësit e luftonin këtë dhe e ndalonin duke pasur përkrahjen e dijetarëve për këtë veprim të tyre.

Es Semehudi thotë: “Mosnjohja e varrit të Fatimes, radijAllahu anha, dhe të tjerëve nga radhët e selefit është çështje e patjetërsueshme, meqë ata kurrë nuk kanë ndërtuar diçka mbi varret e as nuk i kanë betonuar¹²”.

Ibën Tejmije llogaritet nga dijetarët që më së shumti i kishte kushtuar rëndësi dukurisë së kuburizmit. Ai e kishte studiuar historinë e kuburizmit në umetin islam dhe shkaqet e përhapjes së tij dhe se kush qëndronte pas shfaqjes së tij, shenjave dhe simboleve të tij si dhe themelet e shtyllat mbi të cilat ngrihet, por edhe për pasojat e tij në devijimin dhe largimin nga ligjet e sheriatit dhe zbulimin e së vërtetës së teprimit me varret.

Duke sqaruar diçka nga historia e kuburizmit Ibën Tejmije gjatë të folurit për shtetin e abasitëve thotë:

¹¹ “El Umm” (11/277).

¹² “Vefaul vefa bi Ahbari daril Mustafa” (3/93).

“Atëkohë ata nuk i madhëronin varret e ngritura qofshin ato të vërteta apo të rreme sikurse ndodhi më pas, meqë atëkohë Islami akoma ishte në lulëzimin dhe fuqinë e tij. Në kohën e sahabëve, tabiinëve dhe të shoqëruesve të tyre nuk kishte diçka të tillë në vendet islame, as në Hixhaz, as në Jemen, as në Sham, as në Irak, as në Egjipt, as në Hurasan e as në Marok. Nuk ishte shpikur akoma asnjë tyrbe as mbi varr të ndonjë Pejgamberi, as të një sahabi, as të dikujt nga alu bejti e as të ndonjë të devotshmi në realitet.

Shumica e këtyre tyrbeve janë shpikur më pas dhe shfaqja e përhapja e tyre ndodhi kur u dobësua kalifati i abasitëve, kur u përça umeti dhe u përhapën brenda tyre zindikët¹³, të cilët shtireshin si muslimanë dhe u përhap tek ata fjala “ndjekës të bidatit”, që ndodhi në shtetin e Muktedirit, kah fundi i shekullit të tretë. Që atëherë dolën në shesh fraksioni keramitët ubejdije kaddahije në tokën e Marokut, pastaj erdhën në Egjipt, e thuhet se rreth kësaj kohe u shpikën edhe tatimet në Islam. Në këtë

¹³ Zindikët, shumësi i fjalës zindik, që do të thotë i dalë nga feja për shkak të ndonjë veprë kufri ose bidati kufër.

kohë u shfaqën edhe Benu Bevihi, te shumica e të cilëve kishte lajthitje në fe (zandakah) dhe bidate të mëdha. Në shtetin e tyre u fuqizuan Beni Abid El Kaddah në tokën e Egjiptit dhe në shtetin e tyre u shfaq tyrbja që i referohej Aliut, radijAllahu anhu, në krahinën e Nexhfit, kurse para kësaj askush nuk kishte thënë se varri i Aliut ishte aty, por Aliu, radijAllahu anhu, ishte varrosur në Kufe në pallatin e shtetit. Është përmendur se disa kanë rrëfyer nga Reshidi se kishte shkuar tek ai vend dhe ai arsyetohej para të varrosurit aty, pastaj thanë se aty ishte Aliu dhe sa herë që shkonte tek ai varr, i arsyetohej për situatën me djalin e tij dhe kështu u përhap fjala se ai është varri i Aliut, kurse disa të tjerë thanë se ishte varri i Mugire ibën Shu'be¹⁴.

Shumë studiues kanë miratuar se konkluzioni që arriti Ibën Tejmije ishte se nga studimi i historisë tyrbja më e vjetër e njohur në historinë islame ishte ndërtuar në shekullin e tretë hënor dhe këtë e ka përmendur edhe ekspertja e arkeologjisë Dr. Suada Mahir: “Tyrbja më e vjetër në Islam, mbi të cilën është ngritur kupola, është nga shekulli i tretë hënor

¹⁴ “Mexhmu’ul fetava” (27/465).

dhe kjo tyrbe është njohur si “kupola e kryqit”. Ajo gjendet në qytetin e Samurras në Irak, në pjesën perëndimore të lumit Dexe në lindje të pallatit El Ashik...” Taberiu thotë: “Ummu el Halife el Abasi kërkoi leje për ndërtimin e një varri të ndarë për djalin e saj dhe iu lejua, meqë para kësaj ishte zakon që kalifi të varrosej brenda pallatit të tij, kurse ajo e ndërtoi kupolën e kryqit në muajin rebiuth-thani në vitin 284 hënor, e pastaj pranë varrit të Muntësirit iu bashkëngjit edhe ai i kalifëve El Muatez dhe El Muhtedi dhe kjo “kupolë e kryqit” konsiderohet kupola e parë në Islam¹⁵”.

¹⁵ “Mesaxhid Misër” (1/46) nga “Dum\atun alet Tevhid”, 18.

PËRHAPJA E KUBURIZMIT NË BOTËN ISLAME

Me mbizotërimin e injorancës të shumica e muslimanëve dhe pështjellimet e shumta tek ata, si dhe me neglizhencën e dijetarëve në thirrje dhe arsimim, kuburizmi u përhap në botën islame në mënyrë masive. Vështirë se gjen ndonjë qytet apo vend ku nuk ka tyrbe dhe varre me të cilat njerëzit nuk janë të lidhur, duke ua kushtuar adhurimet e ndryshme evliave, të devotshmëve dhe të varrosurve.

Një numër studiuesish kanë numëruar varret në të cilat ka teprime dhe idhujtari ndaj Allahut në shumë vende islame dhe numri i tyre ishte jashtëzakonisht i madh. Për shkak të neglizhencës së umetit kuburizmi ka mbjellë një rrjet të gjerë varresh dhe tyrbesh anekënd botës islame, saqë disa hulumtues arritën të përcaktonin se numri i tyrbeve në një vend nuk është më i paktë se numri i qyteteve dhe fshatrave në atë vend. Ata thonë: “Varret e ‘evliave’ të përhapura në qytetet e Egjiptit dhe gati në gjashtëqind fshatra janë qendra për të praktikuar

mevlude për *muridat*¹⁶ dhe të dashurit e tyre dhe mund të konstatojmë se është e vështirë të gjesh një ditë brenda vitit që nuk bëhet festimi i mevludit (ditëlindjes) së dikujt prej ‘evliave’ në një vend në Egjipt”¹⁷. As fshatrat nuk kanë shpëtuar pa e pasur një varr të ngritur.

Dr. Zekerija Sulejman Bejumi thotë se nuk ka asnjë fshat pa ndonjë tyrbe të evliave, si të Bijjel Arab, Ebu Senitah dhe Mejjit Afif. Të gjitha këto janë qendra (El Baxhur Menufije) dhe hoxhallarët kanë përmendur shembuj të koprracisë dhe zhdukjes së bereqetit nga ato fshatra, të cilat vazhdojnë ashtu deri më sot¹⁸.

Për ta perceptuar më mirë madhësinë e kësaj fatkeqësie, do të sjellim disa shembuj të mundshëm që sqarojnë përhapjen e madhe të këtyre tyrbeve në disa vende të botës islame dhe si zakonisht nuk gjen ndonjë vend që ka tyrbe, që të mos ketë edhe pasuesit që besojnë në të.

¹⁶ Vartësit, imituesit e verbër.

¹⁷ “Mevalid el Misër el Mahruse”, Arafat Abdu Alij (7).

¹⁸ “Et Turuk es Sufije”, fq. 126.

Nga mijëra tyrbet që u atribuohen Pejgamberëve, sahabëve e evliave në botën islame, nga gjashtë mijë prej tyre sa janë në përgjithësi, vetëm në Egjipt janë mbi një mijë tyrbe¹⁹.

Autori i “El Hutat et tevfikije”, Alij Basha Mubarek, përmend se në kohën e tij në Kajro ishin mbi dyqind e nëntëdhjetë e katër tyrbe²⁰, më e njohura prej tyre ishte ajo e Husejnit dhe e zonjës Sukejna, e zonjës Nefise, e zonjës Zejneb dhe tyrbja e Lejth ibën Seadit dhe mbi të gjitha këto tyrbe janë ndër-tuar xhami të mëdha dhe faltore (mesaxhid).

Dr. Suada Mahir përmend se tyrbet e njohura në Egjipt janë mbi një mijë²¹, nga më të njohurat jashtë Kajros janë tyrbja e Bedeviut në Tanta dhe e Ibrahim Desukit në Desuk, e Ebul Abbas El Mursit në Iskenderije dhe e Ebu Derdas po aty, e Ebul Hasen Shadhilij në fshatin Humejthira në komunën e Bahrul Ahmar dhe e Ahmed Ridvanit në fshatin El Bagdadij afër El Aksar, e Ebu Haxhaxh el Aksarij po aty dhe e Abdurahim El Kanait në Kana.

¹⁹ “Dumatun alet tevhidi” (25-26).

²⁰ “El Hutat et Tefvikije” (1/244).

²¹ “Mesaxhidu Misër ve evlijauha” (1/44).

As vendet e tjera nuk janë në gjendje më të mirë se Egjipti, për shembull në Sham janë me dhjetëra tyrbe e teqe të njohura. El Kajani ka përmendur 40 tyrbet që ka vizituar, kurse Abdurrahman Beg Sami (v. 1890) në Damask ka numëruar 194 tyrbe dhe teqe²². Nu'man Kastali i famshëm ka numëruar 44 tyrbe dhe thekson se 27 prej tyre u janë atribuar sahabëve, ku secila prej tyre ka një kupolë që vizitohet dhe kërkohet bereqet prej saj²³.

Kryeqyteti i Perandorisë Osmane, Stambolli, ka 481 xhami dhe gati asnjë xhami nuk shpëton pa tyrbe, më e njohura prej tyre është xhamia e ndërtuar mbi varrin që i atribuohet Ebu Ejub El Ensariut. Në Indi ekzistojnë më shumë se 150 tyrbe të njohura, te të cilat shkojnë me mijëra njerëz, të cilët praktikojnë aty lloje të ndryshme bidatesh dhe idhujtari²⁴. Në Bagdad kishte më shumë se 150

²² “Inhirafat el Akadije vel Ilmije fil karnejni eth Thalith Ashër ve rabiü ashër”, (1/294) Alij Ez Zehrani.

²³ “Revdatul gina fi dimeshk el fajha” (131).

²⁴ “Ed Deaveh es Selefije fi shibhi el Kareti el Hindije” (139).

xhami të mëdha në fillim të shekullit të katërmëdhjetë dhe vështirë se gjen ndonjë xhami pa tyrbe²⁵, kurse në Mosul janë më shumë se 76 tyrbe të njohura, të gjitha brenda xhamive²⁶.

²⁵ “Merahilu el Hajati fil fetretil mudhlime” (1/72).

²⁶ “Terxhumetul evlija fil Musil”, Ahmed el Musili.

PËRHAPJA E VARREVE DHE E TYRBEVE TË RREME

Si rezultat i përhapjes së kuburizmit në botën islame dhe lidhjes së shumicës së muslimanëve të paditur me varret, u përhapën edhe varret e rreme dhe kështu shumë njerëz nisën të pretendonin për disa varre se janë të disa “evliave” dhe njerëzve të devotshëm, por kjo nuk ishte e vërtetë, ishin thjesht gënjeshtria dhe mashtrime.

Ibën Tejmije ishte marrë shumë me këtë çështje dhe kishte vëzhguar varret e rreme duke e dëshmuar me argumente këtë. Ai kishte numëruar edhe shkaqet që çuan deri tek ato gabime të qëllimshme në përcaktimin e varreve dhe i ndau varret në tri kategori. Ai thoshte:

“Varret janë në tri kategori: ka që janë të vërteta, s’ka dyshim, sikurse varri i Pejgamberit tonë, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, dhe i dy shokëve të tij Ebu Bekrit dhe Umerit, meqë kjo është transmetuar

*mutevatir*²⁷, edhe pse disa *rafidij*²⁸ nuk e pranojnë varrin e Ebu Bekrit dhe të Umerit, por rafiditë janë mendjemëdhenj dhe shpifës në rangun e atyre që nuk pranojnë varrin e Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.

Prej tyre ka që nuk janë të vërteta pa kurrfarë mëdyshjeje, si varri që i atribuohet Ubej Ibën Keabit në lindje të Damaskut, meqë krejt njerëzit janë unanimes se Ubej Ibën Keabi vdiq në Medinën Pejgamberike, po ashtu edhe nënat e besimtarëve vdiqën në Medinë, ndaj kush thotë se në mes të Damaskut është varri i Umme Habibes ose i Umme Selemes apo i të tjerave, ai veç ka gënjyer. Por nga sahabet në Sham ishte një grua, që quhej Umi Seleme Esmā bint Jezid bin Seken, e cila kishte vdekur në Sham dhe varri i saj mund të jetë ashtu sikurse mund të jetë varri i Bilalit, meqë ai u varros në Babus Sagir të Damaskut, kështu që e dimë se u varros atje, por prapsepapë nuk mund ta themi prerazi se ai varr është i tij.

²⁷ Transmetime në grup.

²⁸ Shiitët ekstremistë.

Po ashtu edhe varri që i atribuohet Uvejs El Karanit në perëndim të Damaskut është rrenë pa kurrfarë dyshimi dhe Ebu Abdurrahman es Sulemi kishte rrëfyer një tregim se ai ka vdekur në Damask, por është tregim i shpikur, meqë Uvejsi nuk kishte shkuar fare në Sham, por kishte shkuar në Irak.

Po ashtu varri që i atribuohet Hudit në Xhaminë e Madhe të Damaskut është i rremë me konsensus të të gjithë dijetarëve, meqë Hudi nuk kishte ardhur në Sham, por ishte dërguar në Jemen dhe kishte migruar në Mekë. Është thënë se ka vdekur në Jemen, është thënë se ka vdekur në Mekë, por ai varr (që i atribuohet atij) gjendet përballë varrit të Muavije ibën Ebi Sufjanit, meqë pas murit është një tabut në të cilin shkruan Muavije ibën Ebi Sufjan.

Ndërsa varri që gjendet jashtë derës së vogël për të cilin thuhet se është varri i Muaviut, ai në realitet është varri i Muavije bin Jezid bin Muavijes, i cili ishte kalif për kohë të shkurtër, pastaj vdiq dhe nuk la mbrapa trashëgues kurore dhe ishte njeri fetar dhe i devotshëm, mirëpo kur u përhap se ishte varri i Muaviut, njerëzit menduan se ishte varri i Muavije ibn Ebi Sufjanit.

E njëjta gjë thuhet edhe për varrin e Halidit, që ishte Halid ibën Jezid ibën Muavije, vëllai i këtij Jezidit, mirëpo meqë u përhap se është varri i Halidit dhe njeriu i famshëm te njerëzit ishte Halid Ibnul Velidi, ata menduan se ishte varri i Halid ibnul Velidit. Umeri e pati shkarkuar nga udhëheqja e Shamit dhe kishin divergjenca për varrin që ishte në Hums, a është varri i tij apo i Halid ibën Jezidit.

Mospajttime kishte edhe për varrin e Ebu Muslim el Havlanit në Darja, po ashtu edhe për varret e tjera. Ndërsa sa u përket varreve të rreme, ato janë të shumta, si varri i Ali ibën Husejnit që gjendet në Egjipt, pasi Ali ibën Husejni kishte vdekur në Medinë sipas pajtimit të njerëzve dhe u varros në El Bekia. Thuhet se në teqenë e Abasit është varri i tij, varri i Hasanit, i Ali ibën Husejnit dhe i Ebu Xhafer El Bakirit dhe Xhafer bin Muhamedit dhe se në të është koka e Husejnit, kurse trupi i tij në Kerbela me pajtimin e njerëzve. Por, e saktë është ajo që ka përmendur Buhariu në sahihun e tij, se koka e tij ishte bartur tek Ubejdullah ibën Zijadi dhe e kishte parë Enes ibën Maliku.

Po ashtu edhe varri i Nuhut në kodrën Bealebek është gënjeshtër absolutisht, madje ua kam sqaruar rastin e këtij varri banorëve të asaj lagjeje dhe është qartësuar se s'ka bazë që është varri i Nuhut.

Po ashtu u sqarua situata për teqenë e kokës së Husejnit në Egjipt. Ekspertët e kësaj fushe e dinë se koka e gjendur aty nuk është e tij, madje se kjo është gënjeshtër. Esenca është se koka e tij është bartur në Askalan dhe se ajo teqe ishte ndërtuar rreth vitit 560, kurse teqeja tjetër rreth shekullit të gjashtë, afërsisht pesëqind vite pas vrasjes së Husejnit, gjersa Kajroja e ka ndërtuar atë teqe treqind vite pas vrasjes së Husejnit.

Po ashtu varri i Aliut, radijAllahu anhu, i cili gjendet në brendinë e Nexhfit në Kufe, siç dihet nga dijetarët. Ai u varros në pallatin e principatës së Kufes, ashtu sikurse Muaviu u varros në pallatin e principatës së Shamit dhe Amri u varros në pallatin e principatës së Egjiptit. Kjo u bë për shkak të frikës nga havarixhët, se mos ua dhunojnë varret, meqë havarixhët ishin betuar për vrasjen e tyre.

Edhe varri i Xhabirit në Harran nuk është i vërtetë, meqë dihet se Xhabiri vdiq në Medinën Pejgamberike dhe është i fundit që vdiq nga sahabët në Medinë. Po ashtu edhe varri i Abdullah ibën Amrit në gadishull, ku njerëzit janë të pajtimit se ai vdiq në Mekë vitin që u vra Ibën Zubejri dhe porositi që të varroset në El Hil meqë ishte nga muhaxhirët, por meqë kjo ishte e vështirë për ta, ata e varrosën në një vend të lartë në Mekë.

Në shumë nga këto vende ndodhin ngatërrime në emra për shkak se ngjajnë në emërtime, sikurse ka ndodhur për varrin e Muaviut dhe të tjerëve për shkak të ngjashmërisë në fjalë. Ndodh që ndonjë person me emrin Xhabir ose Abdullah ibën Umer ishte varrosur atje, e pastaj injorantët kanë menduar se ai është sahab për shkak të famës së tij dhe kështu dikur bëhet i njohur me të.

E njëjta gjë është edhe me varret e Rukijes dhe Umi Kulthumit në Sham, Egjipt ose diku tjetër, ku disa njerëz mendojnë se është varri i Rukijes, bijës së Pejgamberit ose Umi Kulthumit po ashtu bijës së tij, gjersa njerëzit janë të pajtimit unanimitisht se ato kanë vdekur gjatë jetës së Pejgamberit, sal-lAllahu

alejhi ve sel-lem, në Medinë kur ishin në kurorë me Uthmanin, njëherë njëra e pastaj tjetra. Pas vdekjes së të parës, ai u quajt Dha Nurejn (njeriu i dy dritave). Po ashtu edhe Zejnebi, e bija e Pejgamberit, alejhi selam, e cila kishte vdekur sa ishte ai gjallë. Nuk kishte mbetur nga vajzat e tij veçse Fatimja dhe asnjëra nga vajzat e tij nuk kishte shkuar në Sham, as në Egjipt e as në ndonjë rajon tjetër.

Kështu që varret për të cilat ka patur mospajtime janë të shumta, sikurse varri i Halid ibën Velidit, siç u cek më herët, ku për të ka dy mendime, të cilat i ka përmendur Ibën Abdul Berri në “El Istiab”: njëri mendim thotë se ai vdiq në Homs, kurse tjetri se vdiq në Medinë në vitin 21 ose 22 gjatë kalifatit të Umer ibnul Hatabit.

Ndërsa për varrin e Pejgamberit Ibrahimit, El Halil, alejhi selam, dijetarët kanë thënë se ai është i vërtetë, por se kishte një derë të mbyllur te dhoma e Pejgamberit dhe nuk kishte xhami aty, as nuk falej dikush aty, por kur muslimanët çliruan vendet në kohën e Umer ibnul Hatabit, ua ndërtuan një xhami atyre për t’u falur në atë fshat, ndaras nga

vendi i varrit, mirëpo pas kësaj u rrëzua muri ndarës. Thuhet gjithashtu se pasi të krishterët e morën sërish atë vend, e shndërruan në manastir. E kur e çliruan muslimanët, kalifi El Muteveli Biemrihi nuk kishte dije rreth sunetit që ta drejtonte e ta bënte xhaminë në një vend tjetër, kështu që e shndërroi manastirin në xhami dhe njerëzit e dijes dhe ata që e njihnin sunetin nuk faleshin aty²⁹”.

Nga shkaqet më të mëdha që çuan në shumimin e varreve të rreme dhe teqeve të falsifikuara është mbështetja në ëndrra për t’ua përcaktuar vendin atyre dhe kjo është e mirënjohur, saqë doli në shesh çështja e ashtuquajtur “tyrbet e ëndrrave”, siç e thekson Dr. Suada Mahir: “Kjo u shfaq në shekujt e mesëm, në veçanti në kohët e trazirave dhe luftërave në të cilat popujt nuk gjejnë mbrojtje përpos Allahut, të vetmit, të plotfuqishmit, që pastaj u drejtohen varreve të alu bejtit dhe evlijave për t’i vizituar për begati dhe lutje dhe që Allahu t’ua largojë të keqen dhe t’ua heqë belanë, e pas kësaj u përhap ajo që njihet si “tyrbet e ëndrrave”, ku nëse

²⁹ “Xhamiul Mesail” (4/154-160) dhe “Mexhmuul fetava” (27/457-460).

ndonjë “velij”³⁰ i Allahut nga të devotshmit sheh në ëndërr nxitje për të ndërtuar një xhami apo tyrbe për dikë nga alu bejti ose për ndonjë “velij” të përmendur me emër në ëndërr, ai e ka për obligim ndërtimin e asaj tyrbeje ose xhamie me atë emër³¹.

³⁰ Mik i Allahut, i dashur i Allahut, njeri i devotshëm; njëjësi i fjalës evlia.

³¹ “Mesaxhidu Misër” (1/1-2) përmes “Dumatun alet tevhid”. fq. 22.

DEVIJIMI NË BINDJE TE KUBURIZMI

Dukuria e kuburizmit përmban lloje të ndryshme devijimesh dhe kategorish kundërvajtjesh në besim dhe shariat. Kështu i sheh muslimanët injorantë se si të varret praktikojnë adhurime që nuk i praktikojnë në xhami, në shtëpitë e Allahut të Lartësuar, në të cilat Ai ka urdhëruar të praktikohen dhe që të përmendet Ai. Ata therin kafshë dhe zotohen për varret dhe para tyre dhe i sheh se si falen, bëjnë tavaf, kërkojnë ndihmë dhe thërrasin, u përulen të vdekurve në varre, gjëra të cilat gati askush prej tyre nuk i bën në shtëpitë e Allahut të Lartësuar.

Kështu varret me dukurinë e kuburizmit u shndërruan në fole të kategorive të shirkut ndaj Allahut të Lartësuar dhe amfiteatër i llojeve të bidateve dhe devijimeve që kundërshtojnë fenë e Tij të pastër.

Më pas çdo gjë që ka të bëjë me udhëheqjen hyjnore të kozmosit dhe themelet e veçanta hyjnore ata (adhuruesit e varreve) ua atribuojnë varreve dhe një numër i madh injorantësh nga radhët e muslimanëve të ndikuar nga kuburizmi kanë bindje se varret

janë vend për shërimin e të sëmurëve dhe çlirimin e vështirësive, për realizimin e dëshirave, zbritjen e shiut, furnizimin me fëmijë dhe shumimin e pasardhësve, ruajtjen e pasurisë, familjes dhe fëmijëve!

Jo vetëm kaq, çështja bëhet edhe më e rëndë kur të devijuarit caktuan edhe haxhin për ato varre, duke vendosur rituale për këtë haxh, saqë disa nga ekstremistët e tyre shkruan një libër të titulluar “Ritualet e haxhit dhe tyrbeve (teqeve)” duke i bërë me varre rivalitet Shtëpisë së Shenjtë (Qabesë). Është e dukshme se kjo është ndarje nga feja islame dhe hyrje në fenë e adhuruesve të idhujve³².

Të devijuarit nga radhët e adhuruesve të varreve kanë përmendur shumë lajme dhe udhëzime që shtojnë lidhjen e muslimanëve të padijshëm me varret dhe destinimin e adhurimeve ndaj të adhuruarve (në varre). Shearani thotë: “Sejid Muhamed El Hanefij thotë: “Kush ka nevojë për diçka, le të vijë te varri im dhe le ta kërkojë nevojën e vet dhe unë ia plotësoj, sepse mes meje dhe jush është vetëm një krah dheu largësi dhe çdo njeri që është i penguar prej shokëve të vet nga një krah dheu, ai

³² “Igatherul lehefan” (1/197), Ibën Kajimi.

nuk është njeri³³". Nga Muhamed ibën Ahmed El Fergel transmetohet se ka thënë: "Unë jam nga ata që kanë në disponim (zgjidhjen e çështjeve) nga varret e tyre (!!), kështu që kush ka ndonjë nevojë, le të vijë përballë fytyrës sime dhe le të ma përmendë atë e unë ia plotësoj³⁴"!! Lajme të kësaj natyre janë të shumta.

Dijetarët kanë përmendur raste të shumta që ndodhin nga adhuruesit e varreve të varret dhe Shevkani gjatë sqarimit të gjendjes së adhuruesve të varreve në kohën e tij thotë: "Sa dëme kanë ndodhur gjatë ndërtimit të objekteve të varreve dhe mbrojtjes së tyre, gjë për të cilën qan Islami. Prej tyre është edhe bindja e injorantëve për varret sikurse bindja e jobesimtarëve për idhujt. Kjo u zmadhua duke menduar se ata janë në gjendje të sjellin të mirat dhe të largojnë të këqijat, e kështu i shndërruan si target për kërkim të realizimit të nevojave dhe strehim për arritjen e suksesit të kërkesave, duke kërkuar prej varreve atë që kërkojnë robërit prej Zotit të tyre dhe bënë udhëtime të qëllimshme të përgatitur mirë për

³³ "Et Tabaktul kubra" (1/270).

³⁴ Po aty (1/274).

t'u prekur me to (për bereqet) dhe për të kërkuar ndihmë (prej tyre).

Në përgjithësi ata nuk lanë gjë pa bërë nga punët që bënin njerëzit para Islamit me idhujt, të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi, por përkundër kësaj të keqeje të shëmtuar që veprojnë dhe këtij kufri (mosbesimi) të tmerrshëm, nuk gjen dikë që hidhërohet për Allahun dhe ka xhelozë në mbrojtje të fesë së pastër, as dijetar e as kërkues dije, as udhëheqës, as ministër e as mbret. Na kanë ardhur lajme të konfirmuara se shumica e adhuruesve të varreve kur ndonjë kundërshtar kërkon prej tyre ndonjë betim, betohen rrejshëm për Allahun e nëse u thuhet pas kësaj: Betohuni për shejhun tuaj ose filan person që keni bindje, ata nuk flasin, mundohen t'i ikin, refuzojnë dhe nuk e pranojnë të vërtetën. Kjo është nga dëshmitë më të qarta që aludojnë se idhujtaria e tyre ua ka tejkaluar atyre që thonë se Allahu është i dyti prej të dyve ose i treti prej të treve. O ju dijetarë të fesë dhe o ju mbretër të muslimanëve, çfarë fatkeqësie më të madhe ka për Islamin sesa kufri (mosbesimi) dhe çfarë sprove më të dëmshme ka për këtë fe sesa adhurimi i dikujt tjetër përveç

Allahut? A thua ka ndonjë fatkeqësi që i ka goditur muslimanët e që mund të krahasohet me këtë fatkeqësi?! Çfarë e keqe është obligative të refuzohet, nëse nuk duhet refuzuar kjo idhujtari e qartë?!³⁵

Kur flet për oborrin para tyrbes së Ebi Turabit dhe për idhujtaritë që ndodhin aty, El Makrizi thotë: “Pasha Allahun, fitneja në këtë vend në fund të Harres në Rexhvan, që njihet si Xhafer es Sadik, është fitne e madhe, meqë janë bërë si idhuj që i adhuronin idhujtarët arabë, ku tani populli mendjelehtë dhe gratë u drejtohen atyre me strehim në kohë vështirësish dhe aty paraqesin problemet dhe vështirësitë e tyre, që nuk mund t’u përgjigjet atyre veçse Allahu i Lartësuar, si kthimi i ndonjë borxhi, kërkimi i fëmijëve e të tjera. Ata vendosin vaj dhe gjëra të tjera para atyre varreve me bindjen se kjo i shpëton nga vështirësitë dhe u sjell dobi atyre, por, pasha jetën time, kjo nuk është tjetër veçse një kthim dëshpërues!”³⁶

Njëri nga përkrahësit e shumë dukurive të kuburizmit, Ahmed El Gumari, e ka pranuar se idhujtaria

³⁵ “Nejlul evtar” (4/102).

³⁶ “El mevaïd vel iatibar” (3/94).

ndodh te varret dhe thotë: “Shumica e njerëzve të rëndomtë në Marok shqiptojnë fjalë kufri (mosbesimi) në raport me shejh Abdulkadër Xhejlanin³⁷.”

³⁷ Abdulkadër el Xhejlani el Bagdadij u lind në Kejlan dhe më 488 sipas hixhrit shkoi në Bagdad, ku mësoi nga shumë njerëz të dijes aty. Ai ishte në medhhebin e Imam Ahmedit sa u përket cilësive të Allahut az-ze ve xhel dhe urrente apologjetikën dhe ithtarët e saj, po ashtu edhe në çështjen e kaderit dhe çështjeve të tjera. Ai trashëgoi medresenë e mësuesit të vet, Ebu Seid El Muharremij, ku aty dha mësim derisa vdiq. Këtij dijetari i ishte bërë padrejtësi meqë sufistët dhe kuburijtë kishin gënjyer për të, e disa prej tyre shkuan aq larg saqë kërkonin ndihmë (istigathe) nga ai pos Allahut, duke e quajtur El Gavth (ndihmës), El Kutb el Ekber (poli më i madh). Imam Dhehebiu, rahimehullah, në “Es Sijer” (20/451), në përfundim të biografisë së tij thotë: “Në përgjithësi shejh Abdulkadri ishte njeri me peshë, janë disa vërejtje në fjalët dhe pretendimet e tij, Allahu është takimi, por disa prej atyre pretendimeve i janë atribuar atij rrejshëm”. Ibën Kethiri në librin e tij “El Bidaje ven Nihaje” (12/786) thotë: “Ishte asket i madh, shquhej për devotshmëri dhe keramete, ndjekësit dhe shokët e tij kanë folur shumë për të, duke rrëfyer fjalë dhe veprime nga ai, e kerametet shumica janë ekstremizma të tepruara...” Më shumë rreth biografisë së tij shih librin: “Abdulkadër Xhejlani, mendimet e tij në

Disa prej tyre veprojnë njësoj edhe me të gjallët, duke i rënë në sexhde atij, duke e puthur tokën para tij në formë sexhdeje dhe duart i vënë mbrapa tij si shenjë dorëzimi, përluljeje dhe strehimi, duke kërkuar prej tij në atë gjendje shërimin, pasurinë dhe pasardhësit dhe gjëra të tjera që vetëm nga Allahu i Lartësuar duhen kërkuar.

Te ne në Marok ka prej atyre që i thonë Ibën Meshi-shit: Ai ka krijuar fenë dhe dynjanë!

Prej tyre ka që thonë kur bie shi i madh: -O zotëria ynë Abduselam! Sillu butë me robërit e tu!

E kjo është kufër³⁸.”

Jeta e muslimanëve injorantë e lidhur me varret është bërë një lidhje që tejkalon lidhjen me Allahun e Lartësuar, sepse “janë dashuruar me ta nga të gjitha anët, zemrat janë ashike për ta, u drejtohen atyre në vështirësi dhe situata të rënda, kërkojnë praj tyre shkaqet e fitores dhe zmbropsjen e armiqve, kërkojnë nga ata rriskun, fëmijët dhe shërimin nga sëmundjet dhe janë precizë në lutje para tyre,

besim dhe sufizëm” të Dr. Seid El Kahtanit, (shën. përkthyesi).

³⁸ “Ihjaul makbur” (20).

me bindje se aty lutja është e përgjigjur, nuk refuzohet.

Aty shkojnë edhe ata që u është bërë padrejtësi dhe të shtypurit, me shpresë se do t'u largohet padrejtësia dhe duart e zullumqarëve, por edhe të varfërit dhe skamnorët për të jetuar në hapësirat dhe kohët më fitimprurëse. Aty sakrifikohen kurbane dhe zotime, aty edhe gjynahqarët ikin, strehohen edhe kriminelët dhe ata që kanë frikë, me bindjen se nuk i gjen asnjë e keqe përderisa gjenden në oborrin e “sigurt” të varreve!

Po ashtu i vizitojnë me raste apo festa apo është vendi i fundit nga ku i shprehin lamtumirën familjes dhe vendlindjes apo është vendtakimi kur kthehen në atdheun e tyre. Ndodh që edhe ushtritë të marshojnë nga oborret e tyre pasi kërkojnë nga të zotët e tyre t'i furnizojnë me shkaqet e fitores dhe të triumfit.

Kur dikush prej tyre furnizohet me ndonjë fëmijë, me vrap e dërgojnë te varret për ta bekuar në jetën dhe rriskun e tij, e kush është steril, kërkon nga varri

fëmijë, ndërsa kush është i pamartuar, shpreson ta furnizojë me bashkëshorte³⁹”.

³⁹ “El Inhirafat el Akadije vel imlije” (1/315), Alij Zehrani.

MORALI I SHTHURUR I ADHURUESVE TË VARREVE

Devijimi i kuburizmit nuk është ndalur vetëm te devijimi akaidologjik (në bindje), edhe pse kjo mjafton si shëmti, por këtë e tejkaluan edhe në kategori të devijimeve të tjera morale që bien ndesh me ligjet e shariatit dhe normat e tij. Kjo u manifestua me festime e pirje të alkoolit, amoralitet, lënie të farzeve dhe zhytje në kënaqësi të ndaluara.

Për të treguar disa dukuri të kësaj shthurjeje morale tek adhuruesit e varreve, El Xhibriti kur flet për mevludin e El Afifit thotë: “Pastaj ata shpikën për të një sezon dhe festë në çdo vit, duke thirrur njerëzit për tek ai nga toka e nga deti, pastaj vendosin tenda të shumta dhe tavolina, ngrenë kuzhina e kafene, ku tubohen njerëz të ndryshëm, të veçantë e të rëndomtë, fshatarë e qytetarë, instrumentalistë, valltarë e këngëtarë, lavire, majmunë e magjistarë.

I mbushin shkretëtirat dhe kopshtet dhe shkelin varret e ndezin mbi to zjarre, hedhin sipër tyre mbe-turina, urinojnë dhe kryejnë nevojën, bëjnë kurvëri

e homoseksualizëm, vallëzojnë e kërcejnë, u bien tupanëve e fyejve natë e ditë dhe kjo vazhdon deri në dhjetë ditë apo më shumë. Aty mblidhen edhe disa “fukaha” e “ulema”⁴⁰, të cilëve u vihen tendat po ashtu dhe këta ndiqen nga njerëzit me pozita, nga prijësat e tregtarët dhe nga njerëzit e rëndomtë, të cilët jo vetëm që nuk i këshillojnë për këto shthurje, përkundrazi e konsiderojnë këtë (festim) afrim dhe adhurim!⁴¹”

Për kuburizmin nevojiten hulumtime të veçanta nga ana historike, për shkaqet e përhapjes dhe të avancimit i tij, për shenjat, format e gjurmët e tij fetare dhe shoqërore si dhe studime të tjera.

⁴⁰ Këta janë ulematë e këqinjë, siç i përmend Ibn Kajimi, rahimehullah, në librin e tij “Miftahu daris seadeh”

⁴¹ “Axhaibul athar” (1/304) dhe “El Kuburije” (396-406) të Ahmed El Mualim.

METODA SHERIATIKE NË TRAJTIMIN E KUBURIZMIT

Studiuuesi i teksteve të shariatit dhe i rregullave të përgjithshme të tij e sheh se sheriatu u ka kushtuar rëndësi të madhe varreve. Këtë e ka bërë duke vendosur një numër rregullash dhe ligjesh si dhe shumë prej veprave dhe dispozitave që kanë lidhje me varret i ka vendosur brenda kornizës së çështjeve statike⁴² fetare, ku nuk lejohet ixhtihadi. Termi statik mbi dispozitat e varreve të përdorur nga disa studiues nuk është term i qëlluar, meqë jo krejt dispozitat që kanë të bëjnë me varret janë statike sipas tekstit ekzistues, por disa nga ato, e disa të tjera janë nga ato të lejuarat, të cilat njerëzit mbështeten sipas leverdisë dhe asaj që e shohin më të dobishme për ta.

Se si sheriatu u ka kushtuar rëndësi varreve, kjo vërehet nga tre dimensione:

I pari: **Varri është obligativ dhe përshkrimi i tij është sqaruar** përmes disa gjërave:

⁴² “Kavaid fi tevhid” (202), Velid Es Seidan.

1) Varrosja e të vdekurit është obligim, edhe varri në dhe. Ibnul Mundhiri thotë: “Të gjithë dijetarët prej të cilëve kam mësuar janë të pajtimit se varrimi i të vdekurit është obligim⁴³”.

2) Urdhri për ta thelluar varrin dhe zgjerimin e tij, siç thotë Pejgamberi, alejhi selam: “Bëjeni gropën, zgjerojeni dhe bëjeni për një njeri dhe për tre në një varr (së bashku)!”⁴⁴

3) Urdhri për ta bërë varrin ‘lahd’, pra i anuar kah ana e kibles, siç transmetohet nga Sead ibn Ebi Vekasi, radijAllahu anhu, se ai në sëmundjen e tij të vdekjes tha: “Ma bëni varrin ‘lahd’ dhe murojeni drejt siç vepruan me të Dërguarin e Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem⁴⁵”.

4) Është e ligjshme ngritja e varrit sa një pëllëmbë dhe për këtë arsye varri i Pejgamberit, alejhi selam, ishte i ngritur nga toka sa një pëllëmbë⁴⁶.

5) Bërja e varrit në forme gunge ose të rrafshuar. Pra, pjesa e jashtme e varrit duhet të jetë si gungë e

⁴³ “El Evsat fis Suneni vel Ixhtimai vel Ihtilaf (5/450).

⁴⁴ Transmeton Ebu Davudi (3215) dhe saktësoi Albani.

⁴⁵ Transmeton Muslimi.

⁴⁶ Transmeton Ibni Hibani në sahihun e tij (2160).

majëzuar ose e rrafshuar dhe rreth kësaj çështjeje dijetarët janë ndarë në dy mendime. Disa thanë që të jetë me gungë është më mirë, kurse të tjerët thanë që të jetë i rrafshët është më mirë⁴⁷. Por, mendimi i parë është më i qëlluar për shkak të hadithit të Sufjan Et Temarit, i cili tha: “E kam parë varrin e Pejgamberit alejhis selam dhe ishte si gungë⁴⁸”.

6) Vendorsja e ndonjë shenje mbi varr, që të njihet nga ata që e vizitojnë dhe dëshmia për këtë është se Pejgamberi, alejhi selam, kishte vendosur mbi varrin e Uthman ibën Affanit një gur dhe kishte thënë: “Që ta njoh me të varrin e vëllait tim dhe t’i varros tek ai të vdekurit nga familja ime⁴⁹”.

Është transmetuar nga Ibrahim Nahiu se ka thënë: “E urrenin që të bëhej me shenjë varri⁵⁰”, mirëpo e qëlluara është se kjo lejohet për shkak të argumentit të saktë.

⁴⁷ Shih “El Mugni” (3/437) të Ibën Kudames.

⁴⁸ Transmeton Buhariu (1389).

⁴⁹ Transmeton Ebu Davudi (3206) dhe saktësoi Albani.

⁵⁰ Transmeton Ibn Ebi Shejbeh (11738).

I dyti: **Ruajtja e shenjtërisë së varreve**, e cila bëhet përmes disa gjërave, si:

1) Ndalimi i kryerjes së nevojës në varreza dhe për këtë dëshmon fjala e Pejgamberit, alejhis salatu ves selam: “...dhe ose e bëtë nevojën në mes të varreve apo në mes të tregut (shëmnia është e njëjtë)⁵¹”.

2) Ndalimi i të ecurit me këpucë mbi varre dhe për këtë aludon fjala e tij, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, kur pa një person duke ecur me këpucë mbi varre dhe i tha: “...o ti me dy këpucë lëkure, hiqi ato!”⁵²

3) Ndalimi i të ulurit mbi varre, për shkak të fjalës së Pejgamberit, alejhis salatu ves selam: “Që të ulet dikush nga ju në një gacë zjarri e t’i digjen rrobat dhe t’i arrijë deri te lëkura e tij është më mirë për të sesa të ulet mbi varrin e një muslimani⁵³”.

Imam Maliku dhe ndjekësit e tij kishin kundërshtuar duke lejuar uljen mbi varre meqë hadithin e komentuan se qëllimi prej tij është ulja mbi varre për të kryer nevojën, mirëpo mendimi i qëlluar

⁵¹ Transmeton Ibn Maxheh (1567) dhe saktësoi Albani.

⁵² Transmeton Ahmedi (20784) dhe të tjerët, e saktësoi Shakiri, Albani dhe të tjerët.

⁵³ Transmeton Muslimi (2208).

është i shumicës së dijetarëve dhe dëshmi për këtë është se në disa fjalë të hadithit ka ardhur edhe mbështetja në varr, e mbështetja nuk ndodh me kryerjen e nevojës⁵⁴.

4) Ndalimi i thyerjes së eshtrave të të vdekurit, për shkak të fjalës së Pejgamberit, alejhis salatu ves selam: “Thyerja e ashtit të besimtarit të vdekur është sikur t’ia thyesh sa është i gjallë”⁵⁵ dhe ky hadith është i përgjithshëm, që përfshin qoftë para varrimit apo pas varrimit.

5) Ndalimi i hapjes së varreve, veçse për ndonjë interes të madh dhe për këtë nuk ka ndonjë argument të qartë nga tekstet e shariatit, por është çështje të cilën e kanë miratuar dijetarët me analogji nga kuptimet e kaluara.

6) Vizita e varreve dhe përshëndetja me selam e të varrosurit është e lejuar për shkak të hadithit të Aishes, radijAllahu anha, se kjo kishte pyetur Pejgamberin, alejhis salatu ves selam, çfarë të thoshte kur

⁵⁴ “Imaretul kubur” (5/116) të Mualimiut, rahimehullah (brenda veprave të tij).

⁵⁵ Transmeton Ahmedi (24308), Ebu Davudi (3207) dhe saktësoi Albani.

të vizitonte varret. Ai tha: “Thuaj: Selami qoftë mbi ju, o banorë të varreve nga besimtarët dhe muslimanët, Allahu i mëshiroftë të parët tanë dhe të mëvonshmit dhe në dashtë Allahu, do t’ju bashkëngjitemi juve⁵⁶”.

Disa nga dijetarët kanë përmendur konsensus për lejimin e vizitës së varreve⁵⁷, por e vërteta është se konsensusi nuk është i saktë, meqë imamët e selefit janë kundërshtuar rreth vizitës së varreve sa i përket themelit në tre mendime⁵⁸:

Mendimi i parë: Vizita është mekruh (e urryer) dhe ky është mendimi i Ibrahim Nahiut, Muhamed ibën Sirinit dhe Sheabiut⁵⁹. Ajo që nënkuptohet me mekruh tek ata është ndalesa e prerë.

Mendimi i dytë: Vizita është e lejuar dhe kjo është përcjellë nga një numër i imamëve të selefit. Tirmidhiu e ka përmendur nga Ibnul Mubareku, Shafiu,

⁵⁶ Transmeton Muslimi (2261).

⁵⁷ Shih “El Iatibaru fin nasih vel mensuh” të El Hazimij (284), “Sherhu Sahihul Muslim” (3/145) të Neveviut.

⁵⁸ Shih “Mexhmuul fetava” (27/343) të Ibën Tejmijes dhe “Fer’hul Bari” (3/145) të Ibni Haxherit.

⁵⁹ Prej tyre e ka transmetuar Abdurrezaku në “Musannef” (3/569).

Ahmedi dhe Is'haku, se këta nuk e shohin si të keqe vizitën e varreve.

Mendimi i tretë: Vizita është e preferuar (mustehab). Ky është mendimi i shumicës së imamëve të selefiteve dhe mendimi i qëlluar për shkak të argumenteve të fuqishme nga sheriatu që aludojnë për të. Ibën Tejmije i ka përmbledhur të gjitha fjalët dhe ka thënë: “Të tria mendimet janë të sakta nga njëri kontekst, ku nëse vizita përmban ndonjë element të ndaluar nga shirku (idhujtaria), gënjeshtria ose vajtimi, kjo është e ndaluar me konsensus, si vizita e atyre që i bëjnë idhujtari Allahut dhe ata që urrejnë gjykimin e Allahut⁶⁰. Lloji i dytë është vizita e varreve nga pikëllimi për të vdekurin për shkak se është i afërm. Kjo është e lejuar dhe lejohet të qarët për të vdekurin, por pa vajtim, ashtu si Pejgamberi, alejhi selam, kur vizitoi varrin e nënës së tij dhe qau dhe i bëri të qanin edhe ata që ishin me të. Ndërsa

⁶⁰ Ibën Tejmije këtu ka për qëllim idhujtarët e ndëshkuar e jo krejt idhujtarët, meqë ai e përmendi se Pejgamberi, alejhi selam, vizitoi varrin e nënës së tij dhe një numër dijetarësh kanë nxjerrë fetva se lejohet vizita e varreve të mohuesve.

lloji i tretë është vizita për lutje për të, si namazi i xhenazes, dhe kjo është e lejuara (mustehab) për të cilën aludon suneti që lejohet sepse Pejgamberi, alejhis salatu ves selam, e ka vepruar dhe i mësonte shokët e tij se çfarë të thoshin kur t'i vizitonin varret⁶¹.

I treti: Çdo gjë që shpie në ekstremizëm dhe devijim në raport me to është e ndaluar, meqë shumica e të paditurve kanë lidhje të madhe me varret dhe kanë hamendësime të shumta për to dhe trillime të gjera. Sheriati i pastër ka qenë i kujdesshëm në mbylljen e çdo gjëje që shpie në devijim te varret apo lidhshmërisë me të dhe kjo ndodh përmes disa çështjeve:

Në fillim të Islamit ishte e ndaluar vizita e tyre si masë parandaluese nga shirku. Pejgamberi, alejhis salatu ves selam, thotë: “Ju pata ndaluar nga vizita e varreve, tani mund t’i vizitoni⁶²”.

Po ashtu për shkak të ndalesës për shndërrimin e varreve në festa Pejgamberi, alejhis salatu ve selam,

⁶¹ “Mexhmuul fetava” (27/378).

⁶² Transmeton Muslimi 977.

tha: “Mos i shndërroni shtëpitë tuaja në varreza e as mos e merrni varrin tim për festë dhe çoni salavat mbi mua, sepse salavati juaj më arrin mua kudo që të jeni⁶³”. Në shkakun e kësaj ndalese marrin pjesë edhe varret e tjera.

Kuptimi i “mosshndërrimit të varreve në festa” është ashtu si tubohen nëpër festa, kështu që nuk lejohet përcaktimi i ndonjë tubimi të veçuar me kohë dhe gjendje të caktuar te varret, sepse kjo konsiderohet shndërrim i tyre në varre.

Po ashtu ndalimi i namazit mbi varre ose në drejtim të tyre (përballë), meqë transmetohet nga Ebu Seid El Hudrij, radijAllahu anhu, se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, “e ka ndaluar që të ndërtohet mbi varre ose të ulet mbi to, ose të falet në drejtim të tyre”⁶⁴, dhe transmetohet nga Ebi Murthid El Ganevij, radijAllahu anhu, nga i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, se ka

⁶³ Transmetojnë Ahmedi (8804) dhe Ebu Davudi (2042).

⁶⁴ Transmeton Ebu Jeala në musnedin e tij (1020) dhe e saktësoi Albani në “Tahdhirus Saxhid”, fq. 22.


thënë: “Mos u ulni mbi varre e as mos u falni në drejtim të tyre!”⁶⁵

Këto hadithe dhe të tjera aludojnë se është i ndaluar namazi në drejtim të varreve, pra marrja e varrit si kible të falësit, dhe kjo nënkupton parimisht ndalimin e namazit mbi varr.

Po ashtu, ndalimi i ndërtimit të xhamive mbi varre dhe ndalimi absolut i çdo gjëje mbi varre dhe ky kuptim është më i gjerë se ndërtimi mbi xhami, meqë kjo përfshin kupolat, dhomat dhe gjëra të tjera si dhe ndalimi për të shkruar mbi to, ndalimi i udhëtimit për t'i vizituar ato në veçanti si dhe ndalimi nga ndezja e qirinjve mbi to e gjëra të tjera. Elementi i përbashkët të këto ndalesa në përgjithësi është te paralajmërimi nga ekstremizmi në varre dhe ndalimi i rrugëve që çojnë tek ajo⁶⁶.

⁶⁵ Transmeton Muslimi (97).

⁶⁶ Lexues i nderuar, materiali të cilin e lexuat është pjesë e librit “El Meslek er Reshid” koment i librit “Kitabu Tevhdit” Ibn Abdulvehabit, rahimehullah, i komentuar nga dr.Sulltan El Umejri, profesor akademik i Akides Islame në Universitetin “Ummul Kura” të Mekes.



PËRMBAJTJA

KUPTIMI I KUBURIZMIT DHE HISTORIA E TIJ ...	4
ZHVILLIMI I KUBURIZMIT NË HISTORINË ISLAME	11
PËRHAPJA E KUBURIZMIT NË BOTËN ISLAME .	16
PËRHAPJA E VARREVE DHE E TYRBEVE TË RREME.....	21
DEVIJIMI NË BINDJE TE KUBURIZMI.....	30
MORALI I SHTHURUR I ADHURUESVE TË VARREVE	39
METODA SHERIATIKE NË TRAJTIMIN E KUBURIZMIT	41

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

El Umejri, Sulltan

Kurbanizimi: adhurimi i varreve / Sulltan El Umejri; përsht. Zejd Haziri; red. Arian Koçi.

– Tiranë: Qendra "Udha e Besimtarëve", 2023
... f.; ... cm.

ISBN 978-9928-4757-4-9

1.Feja islame 2. Vdekja 3. Varreza 4. Doktrina fetare

28 -557 -284